

FJALA E DEPUTETIT ISUF ÇELAJ

E ENJTE DATA 13 PRILL 2023

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë të Tropojës, Hasit dhe Kukësit,

Të nderuar kolegë,

Marrëveshja e Republikës së Shqipërisë me Republikën e Malit të Zi për ndërtimin e urës ndërkufitare me fondet e dy qeverive është një veprim, edhe pse jam deputet i opozitës, që e përshëndes. Uroj që kjo të mos mbetet në letër si shumica e marrëveshjeve që ju keni firmosur dhe firmosni vetëm për fasadë propagandistike të stilit tuaj historik, e trashëguar nga ajo që ju përfaqësoni si forcë politike, sepse nga ajo që po shoh sot këtu, po e përdorni vetëm për propagandë elektorale, sepse nuk ka projekt, fonde dhe asnjë gjë. Dua të shpreh shqetësimin tim si përfaqësues i qytetarëve të Tropojës, që ka të bëjë me moszbatimin e një marrëveshjeje ndërmjet dy qeverive, të Malit të Zi dhe të qeverisë shqiptare, e vitit 2013, për hapjen e një pike të kontrollkalimit me Malin e Zi në vendin e quajtur Vranicë, në fshatin Çerem të rrethit të Tropojës. Për marrëveshjen e miratuar para 10 vjetësh nga qeveria e Partisë Demokratike, edhe pse kanë kaluar 10 vjet që ju e drejtoni vendin si mazhorancë, nuk e keni vendosur ujin në zjarr për zbatimin e saj. Sa u takon arsyeve për moszbatimin e kësaj marrëveshjeje unë dhe qytetarët e mi të Malësisë së Gjakovës i kemi të qarta, pasi Tropoja, Hasi dhe Kukësi për ju si mazhorancë gjatë këtyre 10 vjetëve janë trajtuar si qytete të dorës së tretë, si dhe me një urrejtje deri në hakmarrje politike ndaj këtyre qytetarëve, për arsyen e vetme se ata nuk ju kanë votuar dhe as nuk do t'ju votojnë si Rilindje. Shqetësimi im lidhur me moshapjen e kësaj pike të kontrollit të kalimit në Qafë Vranicë në Çerem ka të bëjë me faktin se kjo pikë ka qenë historikisht e hapur në periudhën e mbretit Zog, deri në vitin 1948, kohë kur u mbyll kufiri me ish Jugosllavinë. Kjo pikë u shërben mbi 15 mijë banorëve të rrethit të Tropojës, sidomos gjatë periudhës së verës, pasi lidhjet e këtyre zonave janë të forta me zonat shqiptare të Plavës e Gucisë, një prej trevave dhe luginave më të bukura natyrore, por edhe një prej zonave më patriotike dhe qëndrestare sa i takon çështjes së shqiptarisë dhe çështjeve madhore kombëtare.

Lidhjet familjare dhe martesat e shtuara nëpërmjet këtyre zonave janë shekullore. Këto zona, sidomos pas rënies së diktaturës, vizitohen nga një numër i madh turistësh nga e gjithë bota, si nga brenda, ashtu edhe përtej kufirit, kështu që hapja e kësaj pike kontrolli do t'u shërbente shumë banorëve të zonave Plavë, Guci, Martinaj, Vuthaj, Zabel, Hot e të tjera. Këtyre banorëve, në raste vizitash familjare apo të ndryshme, do t'u duhet të bëjnë mbi 200 e ca kilometra rrugë dhe të kalojnë në dy dogana, në atë të Kosovës dhe të Malit Zi, dhe po kaq në kthim, kjo për vetë pozicionin gjeografik që kanë këto dy zona. Po të hapej pika në qafën e Vranicës, kjo gjë do të bënte të mundur shkurtimin e distancës vajtje-ardhje në më pak se 70 kilometra, duke qenë një lehtësim për këta banorë, gjithmonë nëse qeveria do të kishte menduar për hallet dhe problematikat e këtyre zonave. Kërkesa ime për Kryeministrin, për ministrat Çuçi dhe Xhaçka, është që të angazhohen për zbatimin e marrëveshjes me Malin e Zi, pasi kjo do të jetë në të mirë të qytetarëve të të dyja shteteve. Por, shpresa që ju do të angazhoheni

është thujse zero, pasi, siç jua thashë edhe më lart, për ju këto zona nuk ekzistojnë, sepse nuk mendojnë dhe veprojnë politikisht si ju. Përgjigjen për harresën, varfërinë dhe shpopullimin e Tropojës, Hasit dhe të Kukësit do ta marrim me votë më 14 maj, ditë në të cilën këto bashki do t'u kthehen qytetarëve dhe do të jenë në shërbim të tyre, duke ua hequr nga kthetrat të emëruarve tuaj që i përfaqësojnë këto bashki me veprime abuzive dhe korruptive, ashtu siç është komplet modeli juaj qeverisës. Gjatë 10 vjetëve të qeverisjes suaj zhvillimi në këto zona ka ngelur në vend, ndërkohë që arritja juaj më e madhe është që e keni renditur qarkun e Kukësit në qarkun më të varfër në vend dhe në rajon. Për të gjitha këto, më 14 maj vota e qytetarëve të Kukësit dhe e gjithë Shqipërisë do t'ju ndëshkojnë për të gjitha ato që i keni shkaktuar vendit, korrupsionin galopant, varfërinë e shtuar dhe shpopullimin. Faleminderit!